

KOSOVE



THE WORLD BANK

Gatishmëria e Ballkanit Perëndimor për Investime të Ekuitetit Privat

Mbështetje e menaxhimit financiar për NMVM
për qasje në financim të ekuitetit privat

30 shtator, 2019

Oda Ekonomike e Kosovës

Nëna Terezë, nr. 20

10 Prishtinë

Një event mësimor i Bankës Botërore në bashkëpunim me
Odën Ekonomike të Kosovës



EU-REPARIS is funded
by the European Union
and is a part of WB EDIF



WB EDIF
Western Balkans
Enterprise Development
and Innovation Facility



Rreth eventit

Ky event mësimor një ditor ofrohet nga Qendra e Bankës Botërore për Reformën në Raportimin Financiar në kuadër të projektit për Fuqizimin e Raportimit Financiar dhe Informacionit për NMVM-të në Ballkanin Perëndimor, i cili është një projekt i financuar nga BE-ja në kuadër të iniciativës REPARIS (Rruga drejt Evropës-Programi i Reformës së Kontabilitetit dhe Forcimit Institucional). Eventit përsëritet në [Tiranë, Shqipëri](#); [Banja Lukë dhe Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë](#); [Prishtinë, Kosovë](#); [Podgoricë, Mal i Zi](#); [Shkup, Maqedoni e Veriut](#); dhe [Beograd, Serbi](#).

Eventi përfshin një panel diskutimi angazhues dhe sesione informuese mësimore për mënyrat si ofruesit/

stafi i shërbimit të menaxhimit financiar të NMVM-ve mund t'i mbështesin klientët/punëdhënësit e tyre NMVM të bëhen të gatshëm t'iu qasen investimeve të ekuitetit privat.

Ky event do të pasohet me nisjen e trajnimeve online mbi baza modulare, që do të ofrojnë njohuri më në thellësi për ata pjesëmarrës që kërkojnë të fitojnë njohuri të mëtejshme në lidhje me tregun e ekuitetit privat dhe për mënyrat si ata mund të jenë në gjendje t'i përgatisin më mirë klientët e tyre për investime. Më tej, janë përgatitur një seri infografikash, për referencë nga pronarët/ndërmarrësit e NMVM-ve, për të kuptuar procesin e investimit të ekuitetit privat.

EKUITETI PRIVAT NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Burimi kryesor i kapitalit financiar të disponueshëm për NMVM në të gjithë rajonin është aktualisht përmes bankave; duke marrë linja krediti, kredi bankare dhe forma të tjera të borxhit. Burimet alternative të kapitalit janë ose jo ekzistuese ose me furnizim shumë të ulët.

Tregu i ekuitetit privat në Ballkanin Perëndimor është në një fazë shumë të hershme të zhvillimit, dhe

aktualisht ekziston një mundësi e kufizuar investimi. Sidoqoftë, kjo mund të ndryshojë me kohën, pasi fondet e ekuitetit privat kërkojnë t'i zgjerojnë portofolet e tyre dhe shtrirjen gjeografike, dhe është e rëndësishme që NMVM-të që kërkojnë partnerë të ekuitetit të jenë në gjendje t'i shfrytëzojnë ofruesit e shërbimeve që mund t'u të përgatiten në mënyrë të duhur për investime.

KUSH DUHET TË MARRË PJESË?

Ky event mësimor dhe modulet online janë krijuar posaçërisht për pjesëmarrësit e synuar në vijim:

- Kontabilistët profesionistë* dhe auditorët që punojnë në praktika të vogla dhe të mesme kontabël që u shërbejnë klientëve NMVM
- Kontabilistët profesionistë dhe stafi tjetër i punësuar në një rol financiar në NMVM
- Kontabilistë të tjerë, konsulentë financiarë dhe këshilltarë biznesi që u shërbejnë klientëve NMVM

Edhe pjesëmarrësit e tjerë mund të përfitojnë nga pjesëmarrja në forum, duke përfshirë:

- Ndërmarrësit që dëshirojnë të zhvillojnë vetëdijen për tregun e ekuitetit privat dhe fushat kryesore që duhet të merren parasysh për t'u bërë të gatshëm për investime
- Investitorët e rinj "engjëj" që mund të dëshirojnë të fitojnë një kuptim më të mirë të një procesi të strukturuar investimesh për të mbështetur investimet e tyre
- Këshilltarë dhe mentorët në Inkubatorë dhe Përsheptues

*Professional accountants are qualified accountants that are members of a professional body that has gained membership to the International Federation of Accountants

PSE DUHET TË MERRNI PJESË?

Ky event mësimor (së bashku me modulet online të referuara më poshtë) ju ofron një mundësi të shkëlqyeshme për të marrë njohuri se si funksionon tregu i ekuitetit privat dhe si mund t'u ndihmoni klientëve/punëdhënësve tuaj të bëhen gati për investime.

- Kuptoni si funksionon ekuiteti privat dhe nëse mund të jetë i përshtatshëm për klientët/punëdhënësit tuaj
- Kuptoni procesin me të cilin fillimisht konsiderohet një investim i ekuitetit privat dhe më pas kryhet transaksioni, dhe gjeni specialitetin tuaj për ta

mbështetur klientin/punëdhënësin tuaj që të bëhet gati për investime

- Nëse jeni një investitor i mundshëm: kuptoni proceset e ekuitetit privat për kryerjen e kontrollimit dhe strukturimit të investimeve, çka mund të jenë të dobishëm për ju
- Nëse jeni ndërmarrës: kuptoni si funksionon tregu i ekuitetit privat, në mënyrë që të kuptoni nëse mund të jetë një burim i vlefshëm i kapitalit për biznesin tuaj, dhe çfarë lloj mbështetje profesionale kërkohet për ta kaluar procesin

TRAJNIMI VIJUES ONLINE:

TQëllimi i këtij eventi një ditore është prezantimi i ekuitetit privat tek ofruesit e shërbimeve NMVM, dhe fillimi i rritjes së kapacitetit të tyre për t'u asistuar kompanive NVMV në fazën e rritjes dhe kompanive NVMV të konsoliduara që të mbledhin kapitalin financiar të nevojshëm për të financuar rritjen dhe zgjerimin e tyre, duke i ndihmuar të bëhen të *Gatshëm për Investime*.

Për ta mbështetur këtë event mësimor një ditore, në dispozicion të të gjithë pjesëmarrësve do të vihet një kurs i vetë-drejtuar online, me ftesën për t'u regjistruar dhe për ta përfunduar këtë trajnim online pa kosto. Kursi online do të strukturohet si më poshtë:

HYRJE NË KURS:

- **Moduli 1:** Investimi i ekuitetit dhe ekuiteti privat
- **Moduli 2:** Përdorimi i fondeve
- **Moduli 3:** Kapja e interesit të investitorit
- **Moduli 4:** Negociimi i investimeve të ekuitetit privat
- **Moduli 5:** Pasqyra financiare dhe analiza financiare
- **Moduli 6:** Vlerësimi i kompanisë
- **Moduli 7:** Kujdesi i duhur i ekuitetit privat
- **Moduli 8:** Struktura e ujdisë
- **Moduli 9:** Fleta e termave
- **Moduli 10:** Qeverisja dhe menaxhimi pas investimit

Agjenda

Gatishmëria e Ballkanit Perëndimor për Investime të Ekuitetit Privat

8:15 - 9:00

REGJISTRIM

9:00 - 9:15

FJALËT E MIRËSEARDHJES

- Oda Ekonomike e Kosovës
- Delegacioni i BE-së
- Banka Botërore

9:15 - 10:00

HYRJE

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Pjesa 1: Prezantimi i programit të ditës, kursit online dhe udhëzuesit infografik për ndërmarrësit NMVM. Çka është gatishmëria për investime dhe cili është roli juaj?

Pjesa 2: Përmbledhja e temave kryesore të kursit online, duke përfshirë mënyrën si operojnë fondet e ekuitetit privat dhe si të angazhohesh me ta, qasja e tyre për strukturimin e ujdive, dhe qeverisja e korporatës në ndërmarrjet e ekuitetit privat.

OBJEKTIVAT

- Prezantimi i industrisë së ekuitetit privat dhe aktorëve të saj
- Identifikimi i dimensioneve të gatishmërisë për investime
- Identifikimi i rolit të menaxhimit financiar në gatishmërinë për investime të ekuitetit privat, dhe mënyrat si pjesëmarrësit mund t'i mbështesin klientët e tyre
- Prezantimi i kursit online
- Paraqitja e udhëzuesit infografik të krijuar për ndërmarrësit

Ligjërues: **John Hodge**, *John Hodge, Specialist i Lartë i Menaxhimit Financiar, Qendra për Reformën e Raportimit Financiar, Banka Botërore*
Gavin Ryan, *Konsulent i Bankës Botërore*

10:00 - 10:30

PAUZË PËR KAFE

10:30 - 12:00

INVESTIMET E EKUITETIT PRIVAT: PASQYRA E TREGUT, STRUKTURIMI I UJDISË, VLERËSIMI DHE KUJDESI I DUHUR

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Një përmbledhje e tregut të ekuitetit privat dhe mënyrave si i identifikojnë investimet menaxherët e fondeve të tyre. Kuptimi dhe shikimi i përfitimeve të kryerjes së kujdesit të duhur.

Një përmbledhje e mënyrës si i vlerësojnë kompanitë investitorët e ekuitetit privat, dhe cilët janë faktorët kryesorë që ndikojnë në mënyrën e strukturimit dhe negociimit të ujdive të ekuitetit privat.

OBJEKTIVAT

- Përfitohet një pasqyrë e mënyrës si funksionon ekuiteti privat
- Kuptohen çështjet kyçe në strukturimin e ujdive të ekuitetit privat
- Kuptohen vlerësimi i stilit të ekuitetit privat dhe çka mund të bëhet për ta rritur vlerën e kompanisë suaj para ujdisë
- Kuptohet procesi i kujdesit të duhur: kujdesi i duhur i anës shitëse dhe i anës blerëse

Trajner: **Gavin Ryan**

12:00 - 13:00

DREKË E RRJETËZIMIT

13:00 - 14:30

KOMUNIKIMI DHE NEGOCIIMI I 'INVESTUESHMËRISË' SË BIZNESIT TË KLIENTIT TUAJ

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Krijimi i një përshtypjeje të parë efektive të kompanisë është thelbësor për ta dalluar nga turma. Shkathtësitë e buta janë një përbërës i rëndësishëm i suksesit. Qasja ndaj

negociatave është një faktor i stilit personal, faktorëve kulturorë dhe qasjeve specifike të ekuitetit privat që duhet të merren në konsideratë.

OBJEKTIVAT

- Mësoni si të krijoni një ngacmues efektiv të kompanisë dhe një "propozim rrufe" bindës
- Përfitoni një përmbledhje të praktikave më të mira në negociata
- Identifikoni stilin tuaj personal dhe aspektet kulturore në negociata përmes ushtrimeve në grup

Trajnerë: **John Hodge**, *Specialist i Lartë i Menaxhimit Financiar*,
Qendra për Reformën e Raportimit Financiar, Banka Botërore
Gavin Ryan, *Konsulent i Bankës Botërore*

14:30 - 14:45

PAUZË PËR KAFE

14:45 - 16:15

DISKUTIM NË PANEL: BËRJA GATI PËR MBLEDHJEN E FINANCIMIT TË EKUITETIT

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Anëtarë të shquar të komuniteteve rajonale dhe kombëtare të investitorëve do të diskutojnë opsionet për NMVM-të për të mbledhur financime jo-borxhe, dhe çka

është e rëndësishme që të konsiderojnë për sa i përket të qenit të suksesshëm në qasjen e financimeve të tilla.

OBJEKTIVAT

- Identifikohen burimet aktuale të financave dhe burimet e ardhshme të mundshme
- Përfitohen njohuri nga panelistët mbi çka është e rëndësishme për suksesin e një NMVM-je që kërkon financim të ekuitetit

TEMAT QË DO TË DISKUTOHEN

- Opsionet aktuale të disponueshme për mbledhjen e financimeve jo-borxhe
- Burimet e mundshme të financimit të ekuitetit në planin afatmesëm dhe afatgjatë, dhe vendosja e instrumentit të investimeve
- Histori suksesi rajonal/vendor
- Çka është e rëndësishme, nga këndvështrimi i menaxhimit financiar, në përgatitjen për të kërkuar financim të ekuitetit privat
- Vlerësimi aktual i qeverisjes së korporatave dhe transparencës financiare, dhe si mund të ndikojë kjo në klimën e investimeve.

Moderatorë: **John Hodge**, *Specialist i Lartë i Menaxhimit Financiar*,
Qendra për Reformën e Raportimit Financiar, Banka Botërore
Gavin Ryan, *Konsulent i Bankës Botërore*

16:15 - 16:30

Mbyllja